



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 27 nëntor 2013

Numri i lëndës: 2013-01

I.

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 27 nëntor 2013, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me veprimin e përbashkët të këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Kjo lëndë është regjistruar në Panel më 24 janar 2013. Ankuesi ka kundërshtuar që emri i tij/saj të bëhet publik për shkak të shqetësimeve lidhur me sigurinë e tij/saj personale.

II. FAKTET

Faktet e mëposhtme paraqiten në bazë të informatave që ankuesi/ankuesja i ka parashtruar në Panel.

2. Ankuesi pohon se në qershori 2011 ai/ajo së bashku me 617 qytetarë nga komuna e Kllokotit kanë parashtruar një peticion kundër kryetarit të komunës. Peticioni iu ishte drejtuar ministrisë së vetëqeverisjes lokale dhe kishte të bënte me akuzat për korruption kundër zyrtarëve komunal vendorë.
3. Në të njëjtën kohë, ankuesi së bashku me persona të tjera kanë parashtruar kallëzime penale lidhur me akuzat për korruption kundër kryetarit të komunës së Kllokotit në zyrën e prokurorisë së qarkut në Gjilan. Ankuesi pohon se ata kanë ofruar një numër të konsiderueshëm të dëshmive “që konfirmon keqpërdorimin e pozitës zyrtare të kryetarit të komunës së Kllokotit”. Më tej, ankuesi pohon se të gjitha materialet e rëndësishme ishin parashtruar edhe në departamentin anti korruption në zyrën e policisë në Gjilan.
4. Ky rast ka të bëjë me akuzat për lëshimin e paligjshëm të parave, në vlerë prej rreth 10,000 eurosh, nga thesari i komunës për një kompani private. Dyshohet se paratë ishin ndarë për një projekt që kishte të bëjë me mbjelljen e pemëve dhe rregullimin e një sheshi lojérash të një shkolle. Ankuesi pohon se kjo kompani asnjëherë nuk kishte ofruar shërbimet për të cilat ishte paguar.
5. Me një vendim të datës 28 dhjetor 2012, një ekip i përzier i prokurorëve i përbërë nga prokurori publik i qarkut në Gjilan dhe një prokurori të EULEX-it ka vendosur të ndërpresë hetimin rreth akuzave. Vendimi së pari ka përmbledhur akuzat për korruption të bëra nga banorët e komunës. Më tej ju ka drejtuar pjesëve të ndryshme të dëshmisë, të cilat ishte marrë gjatë hetimit. Autoritetet e ndjekjes kanë marrë dëshmi nga deklaratat e të pandehurve. Gjithashtu kanë marrë në pyetje një numër dëshmitarësh që jetojnë në komunë (B.B., J.J., Z.B., S.M., D.S., H.R., M.B., A.E., T.S., F.H. dhe Z.C.) dhe ka emëruar ekspertë financiarë për të shqyrtuar dokumentet financiare që lidhen me rastin. Gjithashtu iu ka drejtuar gjëra të papërcaktuar të “dëshmive fizike” të papërcaktuara.
6. Prokuroria kishte caktuar një numër ekspertësh për të shqyrtuar dokumentet financiare të komunës me qëllim që të vërtetohet nëse ishte kryer vepra penale e “keqpërdorimit të pozitës zyrtare ose autorizimit”. Në vendimin e vet të datës 28 dhjetor 2012, prokuroria ka marrë parasysh përfundimin e ekspertit, i cili kishte konstatuar se procedurat e prokurimit ishin ndjekur në përputhje me ligjin mbi prokurimin publik. Ata kanë arritur në përfundimin se nuk ishte kryer asnjë shkelje. Prokurori gjithashtu ka kërkuar nga eksperti që të ofronte mendimin e tij se a ishte bërë përgjedhja e operatorit ekonomik në pajtim me ligjin për prokurim publik. Eksperti kishte arritur në përfundim se ashtu kishte ndodhur dhe se asnjë dëm

financiar nuk kishte rezultuar ndaj komunës si pasojë e veprimeve ndaj të cilave kishte pasur ankesë.

7. Vendimi i prokurorit për ta ndërprerë hetimin nuk përbante ndonjë përshkrim të hollësishëm të fakteve ashtu siç janë konstatuar në bazë të provave.
8. Autoritetet ndjekëse kanë arritur në përfundim, duke iu referuar në vija të përgjithshme provave të përmendura më lartë dhe në veçanti mendimet të dhëna nga ekspertët, se nuk kishte rast për t'u hapur ndaj askujt, pasi nuk ishte kryer asnjë vepër penale.

III. ANKESAT

9. Ankuesi pohon se ai si qytetar i komunës së bashku me 617 individë të tjera, të cilët kanë nënshkruar petitionin, ishte drejtpërdrejt të prekur nga vepra e dyshuar e korruptionit e kryetarit të komunës dhe se në këtë mënyrë të drejtat e tij themelore të njeriut janë shkelur. Në veçanti, ankuesi pohon se paraja publike për një projekt për mbjelljen e pemëve dhe rregullimin e një sheshi lojërash të një shkolle në komunë ishin shpërdoruar.

IV. LIGJI

10. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të përdor instrumentet e të drejtave të njeriut të dhëna në konceptin e llogaridhënieve së EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Konventa Evropiane përmes Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, që përcaktojnë standarde përmes mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të cilat duhet të garantoohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike janë të një rëndësie të veçantë për punën e Panelit.
11. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.

Veprimet e ndërmarra nga prokurorët e EULEX-it

12. Paneli tashmë ka konstatuar se veprimet e prokurorëve apo policisë së EULEX-it marrë brenda kontekstit të një hetimi penal janë pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it të Kosovës dhe për këtë arsy mund të hyjnë në kuadër të mandatit të Panelit (shih për shembull Z kundër EULEX-it, 2012-06, 10 prill 2013, në paragrafin 32; W kundër EULEX-it, 2011-07, 5 tetor 2012 në paragrafin 21; Hoxha kundër EULEX-it, 2011-18, 23 nëntor 2011 në paragrafin 22 dhe Slobodan Martinovic kundër EULEX-it, 2011-13, 23 nëntor 2011 në paragrafin 16).

13. Paneli më tej ka konstatuar se veprimet ose mosveprimet nga prokurorët gjatë fazës hetimore të procedurës penale nuk mund të konsiderohen si janë bërë në kuadër të "procedurave gjyqësore (shih *Thaqi kundër EULEX-it*, 2010-02, 14 shtator 2011, par. 64). Në këtë aspekt, Paneli ka konstatuar se "veprimet dhe mosveprimet e prokurorëve të EULEX-it [...] para ngritjes së aktakuzës mund të bien në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it" (shih *Z kundër EULEX-it*, 2012-06, 10 prill 2013 në par. 33; *Thaqi kundër EULEX-it*, 2010-02, 14 shtator 2011 në par. 93). Paneli për këtë arsyе ka pranuar se ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë lëndë.
14. Paneli vëren se autoritetet ndjekëse kanë grumbulluar dëshmi nga burime të ndryshme nëpërmjet marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe ekspertëve financiarë si dhe nëpërmjet shqyrtimit të provave të papërcaktuara fizike.
15. Paneli megjithatë vëren se vendimi i prokurorit i datës 21 dhjetor 2012 nuk i mundëson Panelit që të konstatoj se cilat fakte janë vërtetuar nga autoritetet e ndjekjes në bazë të dëshmive në dispozicion të tyre. Për shembull nuk ka pasur gjetje të faktit nëse pemët ishin mbjellë në të vërtetë sëç ishte planifikuar dhe se sheshi i lojërage i shkollës ishte rregulluar apo jo. Nuk kishte pasur gjetje të tjera të faktit në lidhje me akuzat për korruption. E as nuk është shpjeguar se si janë zbatuar dispozitat e së drejtës materiale nga prokuroria për rrëthanat e lëndës dhe cili ishte arsyetimi që e kishte çuar autoritetin e ndjekjes në vlerësimin ligjor se nuk ishte kryer ndonjë vepër penale.
16. Megjithatë, pavarësisht prej mangësive të caktuara të vërejtura nga Paneli në vendimin e prokurorit për të ndërprerë hetimin, Paneli konstaton se sipas rregullës 25, paragrafi 1 i rregullores së punës, ai mund të shqyrtojë vetëm ankesat nga personat të cilët pohojnë se janë viktimi e ndonjë shkelje të të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në gjyqësi, polici dhe doganë. Paneli do t'i kthehet kësaj pyetjeje në vijim.

Statusi viktimi

17. Në lidhje me këtë, Paneli vëren se ankuesi pretendon se ai është viktimi e veprës së dyshuar për korruption të kryetarit të komunës ku ai jeton. Paneli konstaton se nuk është konstatuar akuza për korruption dhe në të vërtetë ajo ishte hedhur poshtë nga autoritetet kompetente.
18. Pas miratimit të fundit të një sërë dokumentesh ndërkombëtare (krahasoni për shembull deklaratën-ndër rajonale për korruption dhe të drejtat e njeriut të dhënë në seancën e 20-të të Këshillit të të Drejtave të Njeriut në emër të 134 shteteve), duke përfshirë Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korruptionit, Paneli pranon seriozitetin e problemeve dhe kërcënimëve që vijnë nga korruptioni ndaj stabilitetit dhe sigurisë së shoqërive, duke minuar institucionet dhe vlerat e demokracisë, vlerat etike dhe drejtësinë.

19. Paneli më tej pranon se në situata të caktuara korruzioni mund me të vërtetë të arrijë në ose të përfshijë ndonjë kërcënëm ndaj gëzimin efektiv të të drejtave të njeriut. Paneli thekson se korruzioni në masën që e minon sundimin e ligjit dhe besimin e qytetarëve ndaj efikasitetit të sistemit ligjor mund të përbëjnë një pengesë të pakapercyeshme për realizimin efektiv dhe gëzimin e të drejtave të njeriut.
20. Megjithatë, lidhur me kuptimin e fjalës "viktimi", Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka gjetur në shumë raste se "viktima" sipas Konventës tregon personin që është i prekur drejtpërsëdrejtë nga veprimi apo mosveprimi në fjalë (shih midis shumë autoriteteve *Amuur kundër Francës*, 25 qershor 1996, par. 36, Raportet e Gjykimeve dhe Vendimeve 1996-III).
21. Paneli nuk e përjashton si të tillë se sjellja e korruptuar e një zyrtari publik do të mund t'i japë një individi statusin e viktimës, të drejtat e njeriut të të cilët janë prekur nga një sjellje e tillë. Megjithatë në mënyrë që kjo të përbëjë rast, do të duhej të ishte e nevojshme të konstatohej një lidhje midis sjelljes së dyshuar për korruzion dhe pasojave të dëmshme për të drejtat e njeriut ndaj atij individi.
22. Në lidhje me këtë, Paneli vëren se ankuesi nuk ka parashtruar argumente që do të lejonin Paneli për të pranuar se ai vetë kishte pësuar pasoja të dëmshme si rezultat i sjelljes së dyshuar të autoriteteve komunale, përveç pakënaqësisë së tij rrëth gjoja ndarjes jo të duhur të pjesës së buxhetit komunal. Nuk është treguar se vendimi për të ndërprerë hetimin ka prekur të drejtat e njeriut të ankuesit, apo qoftë edhe të drejtat e njeriut të personave të tjera, të cilët kishin parashtruar ankesën e tyre tek autoritetet e ndjekjes për atë çështje.
23. Prandaj, Paneli nxjerr si përfundim se parashtruesi i ankesës nuk mund të pretendoj se është viktimi e shkeljes së të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë sipas rregullës 25, paragrafi 1 i rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI

gjen se kjo ankesë sipas nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës është e pabazuar, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Pér Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese